REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

*Nr. 12174 Prot* *Lezhë, më 29 / 06 /2022*

**VENDIM**

**Nr. 73, Datë 28 . 06 .2022**

**PËR**
**"PËRDORIMIN E METODOLOGJISË LOD PËR ALOKIMIN E FONDEVE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR FONDIN E MIRATUAR PËR SPORTIN, DISPISPLINA FUTBOLL ME VKB NR 58, DATË 13/06/2022"**

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 25 Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese; Ligjin Nr. 79 " Për Sportin", ndryshuar me ligjin Nr 105/2020, neni 20 dhe 21, VKB Nr. 211 datë 31/10/2017 "Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile (LOD)" pika 2. "Të miratohet Metodologjia LOD për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile, të propozuar nga UNDP dhe të miratuar nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë", VKB Nr 57, datë 13/06/2022 " për miratimin e prioritetit per financimin e shoqatave sportive të federuara me objekt futbollin për të përfaqësuar Lezhën ne kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të nxitur të rinjte e talentuar në futboll në Bashkinë Lezhë" si dhe VKB Nr 58 datë 13/06/2022 "Për një ndryshim në VKB Nr.177, datë 23/12/2021 " Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e përdorimit të metodologjisë "LOD" për alokimin e fondeve për Organizatat e Shoqërisë Civile për fondin e miratuar për sportin, disiplina futboll me VKB Nr 58, Datë 13/06/2022, " Për Miratimin e Buxhetit Për Vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024" Pika 1.1
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI**
**ERNEST RAKAJ**

**Në mungesë dhe me autorizim**
**ZV/KRYETARI**
**NDUE LULI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA LEZHË

Prot 12174/1
Dt. 5.7.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PREFEKTI I QARKUT LEZHË**
**SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA**

Nr. 451/9 Prot.

Lezhë , më 04.07.2022

Lënda : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2, gërma b, ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 79/2017 "Për sportin", i ndryshuar; VKB Lezhë nr. 211, datë 31.10.2017 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë, si dhe miratimin e metodologjisë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile (LOD)"; VKB Lezhë nr. 57, datë 13.06.2022 "Për miratimin e prioritetit për financimin e shoqatave sportive të federuara me objekt futbollin për të përfaqësuar Lezhën në kompeticione kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të nxitur të rinjtë e talentuar në futboll në Bashkinë Lezhë" dhe VKB Lezhë nr. 58, datë 13.06.2022 "Për një ndryshim në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 73, datë 28.06.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për përdorimin e metodologjisë LOD për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile për fondin e miratuar për sportin, disiplina futboll me VKB nr. 58, datë 13.06.2022".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

Adresa: Lagjja "Skenderbej" Lezhë prefektura_lezhe@yahoo.com Tel. & Fax. 0215 2220